

V E N D I M
Nr.371, datë 4.8.1999

**PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT NË FUSHËN E STANDARDIZIMIT, TË
ÇERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

KREU I
KRITERET DHE KOMPETENCAT PËR STANDARDIZIMIN

1.Kriteret bazë të standardizimit janë:

- miratimi me konsensus;
- pjesëmarrja e lirë e të gjithë të interesuarve dhe barazia ndërmjet tyre;
- transparencë;
- mbrojtja e interesave të konsumatorit;
- orientimi drejt nivelit të arritur të shkencës, teknikës dhe teknologjisë, në prodhim dhe shërbim, për të mënjeluar pengesat teknike në tregti;
- njësimi i metodikave të analizave për vlerësimin e cilësisë.

2. Standardet propozohen nga subjektet e interesuara dhe nga komitetet teknike (KT). Hartimi bëhet nga KT-të, të cilat krijohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), në bazë të intersit të palëve. Në KT bëjnë pjesë përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve publike, universiteteve, institucioneve kërkimore shkencore, të prodhuesve ose tregtuesve, si dhe të konsumatorëve. Kryetari i KT-së caktohet nga DPS-ja, me propozimin e KT-së përkatëse. Sekretarët e KT-së janë punonjës të DPS-së. Paga e tyre barazohet me pagën e shefit të sektorit të DPS-së. Kryetarët e KT-së shpërblehen me 2000 (dy mijë) lekë në muaj nga fondi i DPS-së.

3. Standardet miratohen nga KT-ja dhe ratifikohen nga drejtori i përgjithshëm i DPS-së. KT, kur e gjykojnë të nevojshme, mund të miratojnë dhe përshtatjen e standardeve, europiane ose ndërkombëtare, duke përkthyer vetëm faqen e parë ose duke i përshtatur pa përkthim.

4. KT funksionojnë sipas rregullores së brendshme, e cila miratohet nga DPS-ja. Në varësi të vëllimit të punës për hartimin e një standardi, KT-ja mund t’ua delegojë detyrat nënkomiteteve teknike, grupeve të punës ose ekipeve të veçanta.

5. Për produktet e reja KT-të hartojnë standarde eksperimentale. Standardi eksperimental, si rregull i përgjithshëm, mbetet në fuqi deri në tre vjet nga data e miratimit të tij. Pas kësaj periudhe, kur shihet e nevojshme, kthehet në standard.

6. Për periudhën tranzitore, të caktuar në ligj, DPS-ja boton në buletinin e vet informativ emërtimet dhe numrat e standardeve të detyruara, të cilat do të kenë këtë status, deri më 22.4.2002. Për këtë qëllim DPS-ja bashkëpunon me ministritë e interesuara, me synim zvogëlimin e numrit të standardeve të detyruara.

KREU II
ÇERTIFIKIMI

7. Kriteret bazë të certifikimit janë:

- paanshmëria e organizimit të certifikimit;
- transparencë e procesit;

- karakteri vullnetar i përdorimit të tij.

8. Procedura e çertifikimit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në standardet europiane të çertifikimit, të përshtatura si standarde shqiptare; sipas udhëzimeve të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO) dhe sipas rregullores së çertifikatës të DPS-së.

9. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, vetëm për produktet që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, me shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit, sipas rregullave teknike në fuqi, përcaktojnë ato të cilat u nënshtrohen çertifikimit të detyruar, provave, matjeve ose inspektimit. Këto rregulla janë të njëjta si për subjekte vendase, ashtu edhe për subjektet e huaja. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore mund të lejojnë futjen në treg edhe të produkteve të çertifikuara, të provuara, të matura ose të inspektuara nga organizma të huaj, në rast se për këtë qëllim ekzistojnë marrëveshje dy ose shumëpalëshe. Kur është e nevojshme të merren monstra për analiza, zbatohet e njëjta procedurë si për subjektet vendase, ashtu edhe për të huajat. Për produkte që vlerësohen me shkallë të ulët rreziku, lejohet që ato të qarkullojnë në treg pa kaluar procesin e çertifikimit, por pasi të jetë bërë verifikimi i dokumentacionit shoqërues të tyre.

10. Për kontrollin dhe rregullimin e veprimtarisë teknike të çertifikimit pranë DPS-së funksionon bordi i çertifikimit me 5 deri 7 anëtarë. Në përbërje të këtij bordi janë përfaqësues nga ministritë, nga dhomat e tregtisë dhe të industrisë, shoqatat e konsumatorëve dhe nga Drejtoria e Standardeve. Anëtarët propozohen nga sektori i çertifikimit dhe miratohen nga titullari i DPS-së për një periudhë 3 vjeçare. Rregullimi i veprimtarisë së bordit bëhet me rregulloren e brendshme të funksionimit të tij. Anëtarët e bordit shpërblehen me 2000 (dy mijë) lekë në muaj nga fondi i DPS-së.

11. Shpenzimet për kryerjen e çertifikimit përcaktohen nga DPS-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ato janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe për të huajat. Këto shpenzime përballohen nga prodhuesi ose importuesi i produktit.

KREU III AKREDITIMI

12. Kriteret bazë të akreditimit janë:

- paanshmëria e organizimit akreditues;
- transparenca;
- karakteri vullnetar i tij.

13. Procedura e akreditimit kryhet sipas standardeve europiane të serisë EN 45000, të përshtatura si standarde shqiptare; sipas udhëzimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO) dhe sipas rregullores së akreditimit të DPS-së.

14. Sektori i akreditimit pranë DPS-së njihet si organizmi kombëtar i akreditimit. Ky organizëm akrediton, sipas kërkesave, organizmat e mëposhtëm:

- laboratorë provash/analizash;
- laboratorë kalibrues
- organizma që kryejnë çertifikimin e produkteve;
- organizma që kryejnë çertifikimin e sistemeve të cilësisë;
- organizma që kryejnë çertifikimin e personelit;
- organizma inspektues.

15. Për akreditimin e laboratorëve shqiptarë lihet një kohë prej dy vjetësh. Laboratorët shqiptarë mund të akreditohen edhe nga organizma të huaj ndërkombëtarë të akreditimit, të cilët janë anëtarë të organizmave ndërkombëtarë ose europianë të akreditimit.

16. Për kontrollin dhe rregullimin e veprimtarisë teknike të akreditimit, pranë DPS-së funksionon këshilli i akreditimit me 5 deri 7 anëtarë. Në përbërje të këtij këshilli janë përfaqësues nga ministritë, nga dhomat e tregtisë dhe të industrisë, nga universitetet, nga organi kombëtar i meteorologjisë dhe nga standardet. Anëtarët propozohen nga sektori i akreditimit dhe miratohen nga titullari i DPS-së, për një periudhë 3-vjeçare. Rregullimi i veprimtarisë së bordit bëhet me

rregulloren e brendshme të funksionimit. Anëtarët e bordit shpërblehen me 2000 (dy mijë) lekë në muaj nga fondi i DPS-së.

17. Shpenzimet për kryerjen e akreditimit ose të verifikimeve përkatëse përcaktohen nga DPS-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ato janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu edhe për të huajat. Shpenzimet për akreditimin përballohen nga subjektet që bëjnë kërkesë.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

18. Të gjitha subjektet juridike e fizike, sipas interesit të tyre, mund të bëhen bashkëpunëtorë të DPS-së. Kushtet përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet palëve.

19. DPS-ja krijon të ardhura nga shërbimet e mëposhtme, që u kryhen të tretëve, si:

- nga shitja e standardeve, shqiptare e të huaja, si dhe të materialeve të tjera teknike;
- nga akreditimi;
- nga certifikimi;
- nga këshillimi teknik për standardet, akreditimin dhe certifikimin;
- nga dhënia e informacionit për standardet, akreditimin dhe certifikimin;
- nga kuota e anëtarësisë së bashkëpunëtorëve.

20. Për periudhën tranzitore deri në tre vjet do të vazhdojnë të kontrollohen ato produkte që mbulohen me standarde të detyrueshme, duke patur parasysh që të lejohen të futen në treg produktet, të cilat kanë treguesit e sigurisë së jetës, të shëndetit dhe të mbrojtjes së mjedisit, jo më poshtë se niveli i standardeve të detyrueshme shqiptare. Për kryerjen e kontrollit ngarkohen ministrinë dhe DPS-ja. Në përfundimin të kësaj periudhe, detyrat e kontrollit do të kryhen nga ministrinë përkatëse.

21. Produktet e importit, të cilat mbeten me standardet të detyruara, janë sipas grupeve të mëposhtme:

Makineri dhe pajisje:

- Boileret;
- Makineri që drejtohen në mënyrë elektrike;
- Makineri metalprerëse dhe për përpunimin e drurit;
- Pajisje mjekësore;
- Pajisje që përfundojnë ushqime.

Artikuj konsumi

- Medikamente;
- Artikuj kozmetike;
- Detergjentë në bazë sintetike;
- Pajisje elektrike për përdorim shtëpiak;
- Televizorë dhe video;
- Pajisje fotografike dhe kinematografike;
- Automobilë;
- Lodra;
- Disa produkte ushqimore.

Lëndë kimike që përdoren në bujqësi

- Pehra kimike;
- Isekticide;
- Kimikate me shkallë të lartë rrezikshmërie.

Ngarkohet DPS-ja për botimin e titujve të tyre.

22. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.187, datë 16.4.1993 “Për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të standardizimit” dhe nr.635, datë 23.9.1996 “Për shpërblimin e anëtarëve

të këshillit të certifikimit” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko